



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 37, datë 01/07/2004

**“PËR
KALIMIN KAPITAL TË DY AUTOBOTEVE DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME NR.1 TË QYTETIT”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr. 7661, dt.19/01/1993 “Për kontabilitetin”, ligjit Nr.6942, dt.25/12/1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” si dhe VKM Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin kapital të mjeteve të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, pika 2/ç, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë kalimin kapital të dy autoboteve nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, në drejtorinë Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI